



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E PERGJITHSHME E PLANIFIKIMIT STRATEGJIK
PER MINIERAT DHE INDUSTRIE
DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TE MINIERAVE

Nr. 2088

Tirane, date 23/2/2015

Drejtuar: Z. Ilgert Qosja, Administrator
Shoqëria "Geri's 2002" Shpk

BULQIZE

Për dijeni: z. Luan Saliaj, Administrator,
Albchrome shpk
Pall. Classic Construction, Kati 2, Rruga Budi, ZK8160

TIRANE

Lënda: Njoftim mbi fillimin e procedurave për revokimin e lejes minerare nr.1181, date 15.05.2008.

I nderuar zoti Qosja,

Shoqëria "Geri's 2002" shpk është zotëruese e leje minerare te shfrytëzimit nr.1181, date 15.05.2008, për shfrytëzimin e sterileve të kromit në objektin Bulqize, Qarkun Dibër.

Në zbatim të nenit 47, pika a1, të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, "Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me kërkesë të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë (MEI), struktura përgjegjëse, AKBN me shkresën nr.2200/1, date 16.02.2014 ka dërguar dokumentacionin e verifikimeve të mbivendosjeve të lejeve minerare në zonën e Bulqizës.

Neni 47, pika a1, e ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, përcakton se një leje minerare revokohet kur:
a/1) konstatohet se zona e licencuar ka mbivendosje të plotë ose të pjesshme, me një leje minerare që është dhënë më parë konform legjislacionit në fuqi në atë periudhë kohore. Në këtë rast, leja minerare, e cila është dhënë në një periudhë kohore të mëvonshme është e pavlefshme për zonën e mbivendosur dhe ministri e revokon atë vetëm për zonën e mbivendosur. Po kështu, ju bejme me dije se, pjesa e mbetur e lejes minerare nuk plotëson kushtet e sipërfaqes minimale të një leje minerare kromi.

Sa me sipër ju njoftojmë se ka filluar procedura e revokimit të lejes minerare nr.1181, date 15.05.2008.

Ju bëjmë me dije se Ministri vendos revokimin e lejes minerare 30 ditë kalendarike pas kalimit të afateve të përcaktuara për njoftimin e dërguar me poste ose të publikuar në faqen e MEI.

Ne zbatim të nenit 49 të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë” duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

